

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 3 dhe neni 20, paragrafi (1) nënparagrafi 10¹ të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 41, paragrafi (6) nga Ligji i njëjtë, neni 1, paragrafi (1), nënparagrafi 3 dhe neni 39, paragrafi (1), nënparagrafi 10 të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, për të marrë vendim lidhur me Njoftimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive XHEZ FM Ljupço SHPKNJP-Shkup, PA1 nr.02-305 datë 5.9.2023, në pajtim me Konkluzionin e Këshillit ark.nr.02-3506/3 datë 25.9.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 30-të mbajtur më 22.9.2023 miratoi si vijon:

VENDIM

1. LEJOHET ndryshim në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive XHEZ FM Ljupço SHPKNJP-Shkup, përkatësisht:

- për largimin e personit fizik [REDACTED] (i mëparshëm nga Shkupi), me NVAQ [REDACTED] me vendbanim të mëparshëm në rrugën „[REDACTED]“ nr. [REDACTED] dhe
- për vendosjen e personit fizik [REDACTED] (i mëparshëm nga [REDACTED]), me NVAQ [REDACTED] dhe adresë në [REDACTED] nr. [REDACTED]

2. Obligohet Shoqëria Tregtare Radiodifuzive XHEZ FM Ljupço SHPKNJP-Shkup, pas ndryshimit të përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi, drejtuar Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele t'ia dorëzojë gjendjen aktuale vijuese të dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) XHEZ FM Ljupço SHPKNJP-Shkup, në pajtim me nenin 41, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.171/14), dhe Njoftim për ndryshim të strukturës së pronësisë PA1 nr.02-305 datë 5.9.2023, e njoftoi Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) për qëllimin e tij për zbatimin e ndryshimit në strukturën e pronësisë të SHTR XHEZ FM Ljupço SHPKNJP-Shkup.

Njoftimi i dorëzuar për ndryshim të strukturës së pronësisë PA1 nr.02-305 datë 5.9.2023, nga ana e SHTR XHEZ FM Ljupço SHPKNJP-Shkup, rezulton i plotë dhe i rregullt, gjegjësisht i përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentet e përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshim të strukturës së pronësisë.

Përkatësisht, për shkak të vdekjes së pronarit të SHTR XHEZ FM Ljupço SHPKNJP-Shkup, është kërkuar pëlqim për venien e personit fizik [REDACTED], me NVAQ [REDACTED] dhe adresë në [REDACTED] në [REDACTED]. Në bazë të Vendimit Oh.Nov.nr.5057/16, UDR nr.83/16 ka hyrë në fuqi më 19.10.2016 (PA1 nr.02-305 datë 12.9.2023) dhe Vendimit Oh.Nov.nr.5057/16, UDR nr.83/16 dhe korrigjimin e të njëjtit më 13.10.2021, ka hyrë në fuqi më 13.10.2021, pas zbatimit të procedurës trashëgimore, personi [REDACTED] djali i trashëgimlënësit, është shpallur trashëgimtar ligjor i së drejtës së pjesës të personit juridik – SHTR XHEZ FM Ljupço SHPKNJP-Shkup me NVAQ 5235715 me seli në rrugën „Simçe Nastevski“ nr.9 B Shkup, Butell, me kapital kryesor të depozitës monetare MKD 314.000,00, pa depozitë jomonetare, pjesa e paguar 314.000,00 dhe kapital bazë në total prej 314.000,00, nga gjendja aktuale me numër 0805-520/150020160283425 datë 19.10.2016 nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë.

Agjencia për të shqyrtuar nëse ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të SHTR XHEZ FM Ljupço SHPKNJP-Shkup do të krijonin përqendrim të paligjshëm mediatik, gjegjësisht nëse janë kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 të LSHMAAV, përmes Sistemit të shpërndarjes së internetit të Regjistrimit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV-së), siguroi

¹Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).

„Informacion për subjektet e ndërlidhura (personat e autorizuar, organet drejtuese, pronarë të subjekteve të tjera) – gjendja vijuese“, me numër 0820-50/150020230233510 datë 12.9.2023, nga ku rezulton se personi Alen Haxhi – Stefanov figuron si:

- drejtues i SHTR XHEZ FM Ljupço SHPKNJP-Shkup (Ky person juridik nuk figuron si pronar i shoqërive tregtare) dhe

- në Shoqatën e Muzikantëve të Xhezit dhe Artistëve të pavarur SHMXH Shkup, aktiviteti prioritar/kodi kryesor i të ardhurave është 94.99 – Veprimtaritë e organizatave të tjera në bazë të anëtarësimit, të pa përmendura në vend tjetër (ky person juridik nuk figuron si pronar i shoqërive tregtare). Në dokumentin nga Regjistri Qendror nuk ka të dhëna për rolin e Alen Haxhi – Stefanov në këtë shoqatë.

Po ashtu, Agjencia ka kontrolluar edhe Regjistrin e pronarëve të vërtetë nga Regjistri Qendror i RMV-së, nga ku është marrë dokumenti „Gjendja vijuese për personin fizik – pronar i vërtetë“, numër 2007-50/150020230233596 datë 12.9.2023, nga ku është vërtetuar se personi Alen Haxhi – Stefanov paraqitet si person i vetëm i autorizuar i radiodifuzerit (transmetuesit) – SHTR XHEZ FM Ljupço SHPKNJP-Shkup.

Pas ndryshimit të kryer në strukturën e pronësisë, pronar i vetëm i SHTR XHEZ FM Ljupço SHPKNJP-Shkup do të jetë personi fizik [REDAKTUAR] me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR]

Duke pasur parasysh se Agjencia ka konstatuar se zbatimi i ndryshimit të strukturës së pronësisë të SHTR XHEZ FM Ljupço SHPKNJP-Shkup nuk krijon përqendrim të paligjshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV, gjegjësisht se ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) dhe 38 nga Ligji i njëjtë, pas paraqitjes së Njoftimit për ndryshim të strukturës së pronësisë PA1 nr.02-305 datë 5.9.2023, Këshilli i Agjencisë, miratoi vendim si në dispozitiv.

Nr.02-305

25.09.2023

Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike

Audio dhe Audiovizuale

Kryetari i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, radiodifuzeri nëse është i pakënaqur, ka të drejtë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit të paraqesë padi për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës kompetente.